



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke



ZL.Anr.253/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziq dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Prizren, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 20.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 3,300.00 (*tremij e treqind*) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, të cilën gjorbë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 18.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik LDK, me rastin e mbajtjes së fushatës zgjedhore në fshatrat Skorobishtë dhe Korishë në Prizren, kanë shkelur nenin 5.2 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013, duke theksuar se ka përfshirë fëmijë nën moshën 18 vjeç. Për më tepër theksohet se kryetari nga radhët e subjektit politik LDK, me datën 17.10.2017 përmes rrjetit social Facebook nga profili i tij ka publikuar fotografi me fëmijë, pra të njëjtit vërehen duke mbajtur simbole të subjektit politik LDK. Më tutje ka theksuar se, qëllimi i postimit të fotografisë nga mbajtja e tubimit ka qenë përmbajtja me elemente të fushatës zgjedhore. PZAP-it i ka kërkuar që me rastin e lartësisë së dënimit, të merr parasysh faktin që subjekti politik LDK ka marrë pjesë në zgjedhjet qendrore dhe lokale dhe i njëjti është i njohur me ligjin zgjedhorë, duke kërkuar me rastin e shqiptimit të jetë e lartë gjoba.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur tri fotografi, të shpërndarë nga Facebooku i subjektit politik LDK.

Në përgjigjen në ankesë të subjektit politik LDK, të datës 19.10.2017, thekson se ankesa e ankuesit është e pa bazuar pasi që pretendimet sipas ankesës janë të pa qëndrueshme, duke theksuar se nga fotot e ofruara si dëshmi nga ana e palës ankuese, vërehet qartë se tubimet janë mbajtur në dy fshatra dhe lokalitete të vogla. Për më tepër thekson se, duke qenë se ambientet kanë qenë të hapura, ka qenë pothuajse e pa mundur të largohen fëmijët, të cilët ishin afruar në tubim, edhe përkundër angazhimit të organizatorëve nga radhët e subjektit politik LDK. Siç theksohet në mes tjerash, nga fotot e ofruara nga pala ankuese, fëmijët qëndrojnë anash dhe jo në pjesën qendrore ku edhe ka qenë hapësira e paracaktuar për të qëndruar pjesëmarrësit e tubimit në fjalë. Më tutje ka shtuar se qëndrimi afër tubimeve si vëzhgues të ngjarjeve nuk mund të trajtohet si përfshirje në fushatë zgjedhore, sepse në shumë raste kur tubimet mbahen në lokalitete të vogla dhe në ambiente të hapura, është pothuajse e pa mundur që të largohen të gjithë fëmijët. PZAP-in e ka njoftuar se subjekti politik LDK, ka kërkuar nga administratorët e faqes së kryetarit të subjektit politik LDK, të largojë fotot me qëllim të evitimit të çdo keqkuptimi apo keqinterpretimi të mundshëm.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga fotografitë e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se subjekti politik LDK, për qëllime elektorale ka publikuar fotografitë të cilat edhe i ka shpërndarë nëpërmjet rrjetit social të subjektit politik në fjalë ku shihet se i njëjti nga fotografitë ka përdorur për fushatë zgjedhore fëmijët nën moshën 18 vjeç, me qëllim të promovimit të subjektit politik LDK dhe të kandidatëve të saj për tu votuar në zgjedhjet lokale të 22.10.2017.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik LDK, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 5.2 të rregullës Zgjedhore 13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike e cila përcakton qartë se, *në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë e punësuarve në institucionet shtetërore dhe publike, organizatat bamirëse dhe fetare, përfaqësuesit e bashkësive fetare, si dhe personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve.*

Nga arsyet e theksuara më lartë, ankesa e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, u miratua si e bazuar pasi që pretendimet në ankesë janë të bazuara në fakte bindëse ku vërtetohet se subjekti politik LDK, ka bërë shkeljen e Kodit të Mirësjelljes të përshkruar si më lart, pra duke u bazuar nga të lartë cekurat, Paneli vendimin e tij e mbështeti në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjekti politik LDK nuk paraqesin shkelje dhe nuk mund të sanksionohen si shkelje e Kodit të Mirësjelljes, për arsye se pjesëmarrja e fëmijëve në tubim të hapur në dy lokacione, nuk mund të konsiderohet si përfshirje në fushatë dhe me arsyetimin se fëmijët në tubim qëndrojnë anash dhe jo në pjesën qendrore ku ishte hapësira e caktuar, pasi që ka qenë e pa mundur nga aktivistët të largohen fëmijët nga mjedisi i tubimit, Paneli pretendimet e tilla i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tilla i refuzoj pasi që këto veprime të subjektit politik në fjalë, janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitë e nenit 5 paragrafi 2 të Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë ne pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në fakt Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha Subjektet Politike, Kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre, që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së LDK-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjektin politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij e ka mohuar shkeljen e supozuar.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.A.nr. 253/2017 më datën 20.10.2017



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.